



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës

04 Nr. 610/01-18315/19

Datë: 21.06.2019

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L- 032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 22/2013 për numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës shpallë:

KONKURS

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e Dhjetë (10) në Gjimnaz dhe Shkollën Profesionale për vitin shkollor 2019/2020

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt
Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10, në gjimnaz dhe në shkollë profesionale, për vitin shkollor 2019/20, mund të konkurrojnë kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç. Nxënësit të cilët e kanë mbaruar klasën e 9 jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.
2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim
Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10 në gjimnaz dhe shkollën profesionale duhet të paraqesin këto dokumente:
Fletëparaqitja (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
Dëftesa origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
Ekstrakti i lindjes.

Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaz dhe shkollë profesionale për vitin shkollor 2019/20, bëhet më datën 24,25 dhe 26 qershor 2019 në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8:00-16:00.

Rezultatet shpallen në shkollat përkatëse me datën 28.06.2019, ndërsa kthimi i dokumenteve për nxënësit të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej 29.06.2019. Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - Komisionit për ankesa.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10 duhet t'i plotësojë këto kriteret:

1. Suksesi nga shkollimi i obliguar (25%) 25 pikë
2. Suksesi nga lëndët prioritare në test (15%) 15 pikë
3. Numri i pikëve nga testi (60%) 60 pikë

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 pikë.

SHMP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka"- KAÇANIK

Nr.	Drejtimi	Profili	Nr. Paraleleve	Nr. Nxënësve
1	Elektroteknikë	- Teknik i telekomunikacionit	1	32
		- Teknik i informatikës	1	32
		- Instalues elektrik	1	24
2	Ekonomi	- Asistent i marketingut	1	32
		- Kontabilitet	1	32
		- Shpedicion dhe logjistikë	1	32
		- Tregti me shumicë dhe pakicë	1	32
3	Makineri	- Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit	1	24
		- Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit	1	24
		- Saldator	1	24
		- Automekanik	1	24
		- Operator i prodhimit	1	32
	Gjithsej		12	344

Gjimnazi “ Skënderbeu” – KAÇANIK

Nr	Drejtimi	Nr. Paraleleve	Nr. Nxënësve
1	Shkenca Natyrore	4	128
2	Shkenca Shoqërore-Gjuhësore	4	128
Gjithsej		8	258

Drejtori i DAK
z. Zahur Doda

